MILAGRO PLUS

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE



"KUJDES"

Shumë toksik për organizmat ujorë, me efekte afatgjata.

"Lexo fletudhëzuesin para përdorimit"

Herbicid sistemik për kontrollimin e barërave të këqija gjethengushta dhe gjethegjera në misër, pas mbirjes.

Përmbajtja: *Dicamba 22 % + Nicosulfuron 5 %.*
Formulimi: *Dispersion vajor (OD).*

Masat parambrojtëse:
• Të ruhet në vende të sigurta dhe larg fëmijëve.
• Mos hani e mos pini lëngje ose duhan gjatë përdorimit.
• Administroni përmbajtjen/kontejnerin në përputhje me ligjin kombëtar.
• Vishni këmishë me mëngë të gjata dhe pantallona të gjata gjatë përzierjes/ngarkimit/trajtimit/rihyrjes në parcelën e trajtuar.
• Asgjeso mbetjet e prduktit sipas rregullave ne fuqi për mjedisin.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:
Në rast se merret me organet e frymëmarrjes: Nxireni të aksidentuarin në ajër të pastër. Mbajeni të ngrohtë dhe të relaksuar. Nëse frymëmarrja e viktimës nuk kthehet, aplikoni frymëmarrje teknike. Thirrni menjëherë mjekun.
Në rast kontakti me lëkurën: Hiqni menjëherë të gjitha rrobat që kanë rënë në kontakt me produktin. Lahuni mirë me ujë të bollshëm. Nëse shfaqet acarim ose skuqje e lëkurës: Konsultohuni / Vizitoni një mjek Hiqni rrobat e ndotura dhe i lani para se ti ripërdorni.
Në rast kontakti me sytë: Shpëlajini sytë mirë me ujë të pastër e të bollshëm për të paktën 15 minuta. Hiqni lentet e kontaktit. Kërkohet kujdes i menjëhershëm mjekësor.
Në rast gëlltitje: Thirrni menjëherë Qendrën e Helmimeve ose mjekun (tregoni etiketën kur është e mundur). MOS nxisni të vjella.
Antidoti: Antidot specifik nuk njihet. Ndiqni trajtim simptomatik.

Përdorimi:
Mënyra e përdorimit:
Me spërkatje gjethore me 10-40 lit tretësirë spërkatëse për dynym. Përdorni sprucatorë të tipit fshesë dhe spërkatni me presion deri në 3 atmosferë.
Misër: për kontrollimin e barërave të këqija njëvjeçare gjethengushta dhe gjethegjera, me 80-120 ml/dynym (max) dhe me 10-40 lit/dynym tretësirë spërkatëse. Një trajtim me spërkatje gjethore nga faza e 2 deri në 8 gjethe të kulturës së misrit (BBCH 12-18).
Mënyra e veprimit: Herbicid sistemik për kontrollimin e barërave të këqija gjethengushta dhe gjethegjera në misër, pas mbirjes. Nicosulfuron vepron duke frenuar enzimën e acetolactate synthazës (ALS) dhe thithet nga gjethet dhe rrënjët, ndërsa dicamba vepron duke penguar rritjen dhe zhvillimin e barërave të këqija dhe thithet nga gjethet, rrënjët dhe lastarët.
Barërat e këqija të kontrolluara:
Talla (Sorghum halepense), Nena e shpërveshur (Amaranthus retroflexus), Bordullaku (Portulaca oleracea),
Meli (Panicum dichotomiflorum), Minueri i bardhë (Chenopodium album), Muhari (Echinochloa crus-galli), Tatulla (Datura stramonium), Abutiloni (Abutilon theophrasti), Ksanti e lungave (Xanthium strumarium), Nejca pjeshkore (Polygonum persicaria), Idhnakthi i zi (Solanum nigrum), Dredhja e arës (Convolvolus arvensis), Meli i përgjakur (Digitaria sanguinalis), Kostreva (Setaria pumila) Nejca pjeshkore (Polygonum persicaria) etj.

Verejtje per perdorimin:
Në tokat me përmbajtje argjili <10%, përdorni dozën e vogël (80 ml/dynym).
Në tokat me përmbajtje argjili >10% përdorni:
Dozat e vogla të përdoren për të kontrolluar barërat e këqija njëvjeçare gjethengushta e gjethegjera në fazën fillestare të rritjes dhe dozat e mëdha në kushte të vështira kur ka një numër të madh të barërave të këqija ose barërat e këqija janë në fazë të përparuar të rritjes ose
Doza maksimale (shuma) për çdo sezon kultivimi nuk duhet të kalojë 120 ml/dynym.
Kushtet specifike bujqësore, shëndetësore të bimëve, ose mjedisit, nën të cilat formulimi mund të përdoret ose përjashtohet:
Të mos përdoret në rast se misri është në gjendje stresi.

Për efikasitet më të madh të përdoret në temperatura midis 25° C dhe 15ºC dhe me lagështirë relative ajrore më të madhe se 60%.
Të mos përdoret te misri i destinuar për prodhimin e farës dhe tek misri i ëmbël.
Të mos përdoret nëse gjatë mbjelljes janë përdorur insecticide granularë organofosforike ose karbamate.
Trajtimi duhet të bëhet së paku një javë pas spërkatjes gjethore me insecticide organofosforike ose karbamate
Të mos e përdoret i alternuar ose në kombinim me produkte që përmbajnë sulfonilurea.
Për të zvogëluar rrezikun e zhvillimit të rezistencës, ndiqni këto praktika bujqësore:
Të zbatohen metoda alternative të kontrollit të barërave të këqija (metoda mekanike, masat e kultivimit, etj.).
Bëni qarkullim bujqësor.
Përdorni dozën dhe kohën e rekomanduar të trajtimit për të kontrolluar barërat e këqija më të vështira.
Alternoni herbicide me mënyra të ndryshme veprimi për të shmangur zhvillimin e rezistencës.

Fitotoksiciteti:
Mund të shfaqen simptoma fitotoksiciteti si klorozë, njollëzim, deformim ose xhuxhizim, por këto janë kalimtare dhe nuk ndikojnë në rendimentin e misrit.

Ndikimi ne mjedis:
Efekti te bletet nuk eshte marre ne konsiderat pasi fazat me te cilen perdoret produkti, nuk perkon me ektivitetin e bletes.
Mos ndotni ujrat me preparatin ose me ambalazhin e tij. Për mbrojtjen e bimëve që nuk janë objekt kontrolli siguroni nga kulturat fqinje: një zonë të pa trajtuar mbrojtëse prej 10 metrash ose një zonë të pa trajtuar mbrojtëse prej 5 metrash në kombinim me përdorimin e sprucatorëve që ulin 50 % krijimin e mjegullës spërkatëse ose një zonë të pa trajtuar mbrojtëse prej 1 meter në kombinim me përdorimin e sprucatorëve që ulin 90 % krijimin e mjegullës spërkatëse kur bëni një trajtim (80-120 ml/dynym).
Për mbrojtjen e organizmave ujorë siguroni nga ujërat sipërfaqësore:
- lini një brez mbrojtës prej 10 m në kombinim me përdorimin e sprucatorëve që ulin 50 % krijimin e mjegullës spërkatëse kur bëni një trajtim (120 ml/dynym).
- lini një brez mbrojtës prej 5 metrash ose përdorni sprucatorë që ulin 50 % krijimin e mjegullës spërkatëse kur bëni një trajtim (80 ml/dynym).
Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin, ndiqni me kujdes udhëzimet e përdorimit.

Pastrimi i makinave të spërkatjes: Rekomandohet përdorimi i tretësirës amoniaku 3% (1 lit/hl) derisa të hiqen të gjitha gjurmët e produktit.
Hapat që duhet të ndiqni gjatë pastrimit janë:
Zbrazni plotësisht rezervuarin e pompës spërkatëse. Çdo ndotje në pjesën e jashtme të pajisjeve spërkatëse duhet të hiqet duke e shpëlarë me ujë të pastër.
Mbushni rezervuarin me ujë të pastër për të kaluar nëpër të gjitha pjesët e pajisjes spërkatëse (pompë, tub spërkatës) dhe zbrazeni përsëri.
Mbushni rezervuarin me ujë të pastër deri në ¼ dhe shtoni 1 litër amoniak (për përdorim shtëpiak 3%) për 100 lit ujë.
Përzieni dhe qarkulloni këtë tretësirë në tubat dhe në spucatorët. Lëreni tretësirën të veproj duke e përziher për 15 minuta dhe më pas zbrazni rezervuarin.
Përseritni hapat 2 dhe 3.
Përdorni të njëjtën tretësirë për të shpëlarë filtrat dhe sprucatorët.

Karenca:
Trajtimi i fundit para vjeljes nuk përcaktohet.
Periudha e sigurisë midis trajtimit dhe:
- mbjelljes me farë ose fidan të kulturës bujqësore që do mbrohet: Në rast dështimi, misri mund të rimbillet, pas punimit të thellë të tokës (20 cm).
- mbjelljes me farë ose fidan të kulturave pasardhëse: Në vjeshtë mund të mbillet grurë apo kolzë dhe pranverën tjetër (1 vit pas trajtimit me MILAGRO PLUS) sorgum, panxhar sheqeri, lulediell pas punimit të thellë të tokës (20 cm).
- rifutjes së njerëzve ose të kafshëve në zonën e trajtuar: Deri sa të thahet tretësira spërkatëse në sipërfaqen e gjetheve.

Kushtet e ruajtjes dhe magazinimi:
Në paketimin e tij origjinal të mbyllur, larg diellit dhe lagështisë, në një mjedis të ajrosur mirë, mbetet i qëndrueshëm për 3 vjet. Të mos ruhet në temperatura mbi 35ºC.

Numri dhe data e regjistrimit: 755, datë 27.1.2021;
Sasinë neto të PMB-së apo lëndës vepruese, që ndodhet në ambalazhin bazë: Deri në 1L;
Numri i serisë ose shenja të tjera identifikuese:_____;
Data e prodhimit:_____;
Datën e skadencës së PMB-së, ruajtur sipas kërkesave të përcaktuara në dosje:_____;
Llojin e ambalazhit bazë: Shishe COEX ose HDPE;
Emri dhe adresa e prodhuesit: SYNGENTA Crop Protection AG. **Adresa:** Basel, Switzerland,;
Emri dhe adresa e aplikantit: SYNGENTA Crop Protection AG. **Adresa:** Basel, Switzerland.